

# **STATUTI I SHOQËRISË**

## **“Jes Finance&Accounting” SH.P.K.**

### **TITULLI I**

**Neni 1:** **Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia dhe hapësira në internet**  
**Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit**

- (1) Sot, më 12.07.2023, në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjt Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjt Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", une themeluesi i "Jes Finance&Accounting" Sh.p.k, kam formuluar statutin e shoqerise, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare, si me poshtë:
- (2) Ortakët themelues i shoqërisë:
- Engjellushe Veisllari , e bija e Peme Cecaj dhe i Enver Cecaj, e datelindjes 15.02.1969, lindur ne Polican, dhe banues ne Durrës, Shqiperi, me karte identiteti nr. 035115172 dhe nr.personal G95215185B..

**Neni 2:** **Objekti**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Jes Finance&Accounting" Sh.p.k, do të zhvillojë aktivitet me objektin e veprimtarisë si më poshtë:

Sherbime konsulencje financiare dhe te tjera te lidhura me te.

**Neni 3:** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë Tregtare "Jes Finance&Accounting" Sh.p.k. është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

**Neni 4:** **Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike**

Selia e Shoqërisë Tregtare "Jes Finance&Accounting" Sh.p.k. është : Rruga A.Goga, apartamenti nr 2, nr pasurise 2/1175+2-2,zk 8511

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë Shqiperise. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e R.SH, në përputhje me ligjet .

- (1) Adresa e Shoqërisë për qëllimin e komunikimit elektronik është si vijon:

- Shqipëri Cel. +355 699425260
- Tel-Fax \_\_\_\_\_
- Email: silvanaveisllari@yahoo.it.com

### **TITULLI II**



## Kapitali

### Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

- (2) Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "Jes Finance&Accounting" Sh.p.k, është 100 all (njeqind) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100 (njeqind) Lekë. Themeluesi merr në pronësi kuotat e tij në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij
- (3) Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

#### Ortakët Themelues:

2. 1. Engjellushe Veislari, e bija e Peme Cecaj dhe i Ervet Cecaj, e datelindjes 15.02.1969, lindur ne Polican, dhe banues ne Durres, Shqiperi, me karte identiteti nr. 035115172 dhe nr.personal G95215185B.

(4) Kontributet e mësipërme janë shlyer tërësisht.

### Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- (1) Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marjes së një njoftimi prej të paktën, katërmëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtuhet thirja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirja për pagesë.
- (2) Zotërueshit e përbashkët të një kuote, mbajnë përgjegjësi bashkarisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.
- (3) Nëse një thirje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se katërmëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.
- (4) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përparrë se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhoqet me vendim të Administratorit dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.
- (5) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderohet e arsyeshme nga administratori.
- (6) Personi prej të cilët janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon së qenë ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përparrë shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontributë përparrë tërheqjes.

### Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tillë siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75%(shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Asamblesë së Përgjithshme.



#### Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruarve të përbashkët sipas Nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit 9901 28.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotëruar. Emrat e zotëruarve të përbashkët renditen në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

#### Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë

- (1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të Shoqërisë.
- (2) Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi.
- (3) Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

#### Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit

- (1) Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruarit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruar i vetëm ose një bashkëzotëruar i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij, janë të vetmit persona, të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por, asnjë dispozitë e këtushme, nuk e çiron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkarisht.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të këruara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotëruar i kuotës të regjistrohet një person tjeter i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruar vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruar i kuotës të regjistrohet një person tjeter, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjeter.
- (3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, fitullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruar i kuotës, me përashtim të faktit që, përpala se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

#### Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro tē ortakëve që përfaqësojnë tē paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë tē drejtë tē nënshkruajnë zmadhimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar kërcohët edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve tē rinj tē hyjnë në shoqëri.
- (2) Me anë tē një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro tē ortakëve që përfaqësojnë tē paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit. Në rast zvogëlimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë tē drejtë tē nënshkruajnë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund tē zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.



#### **Neni 12: Blerja e kuotave nga ortakët dhe të tjerët**

Ortakët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës që shitet përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet edhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënrat e blerës. Ortaku jep ofertën brenda 60 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japid një përgjigje brenda 60 ditëve. Edhe e drejta e përparësisë, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblesë.

E drejta e përparësisë është proporcionale me kuotat e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten.

E drejta e përparësisë është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve. Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 ditëve, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte notariale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

### **TITULLI III**

#### **Neni 13: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- (1) Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, dhe duhet të procedojne me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit.
- (2) Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi te derguar me poste, ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik, duhet të permbole vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites, dhe tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 (shtatë) ditë përpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.
- (3) Kur Asambleja e Përgjitheshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij nenit, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese te gjithe ortaket janë dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

#### **Neni 14: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- (1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumi te parashikuar nga nenit 86 i ligjit. Ortakët ose perfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjese edhe përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88 te ligjit. Ortakët që marrin pjese përmes mjeteve te komunikimit elektronik, kanë të drejtë të votojnë nepermjet numrit PIN-in, që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- (3) Nese asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes, ose nese asnjë prej Administratoreve nuk eshte i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishem me



te drejte vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

- (4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- (5) Kryetari me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon Asambleja e Pergjitheshme), t'i shtyjë mbledhjen e Asamblesë se Pergjitheshme, por në një mbledhje e dyte mund të diskutohen ato cestje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e meparshme e Asamblesë. Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njëtin rend dite.
- (6) Asambleja vendos me votë të hapur, me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet me menyren e duhur, një votim i fshehte. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bëre nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.
- (7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit, se një vendim është miratuar në mënyrë unanim ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- (8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklarate, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

#### Neni 15: Votat e ortakëve

- (1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi ka të drejtën e një vote.
- (2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
- (3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pahequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.

#### Neni 16: Hetimet e posacme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posacëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë notoriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

## TITULLI IV

### Administratori

#### Neni 17: Emërimi i administratorit

- (1) Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të vetëm të shoqërisë për pesë vjet sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës së zakonshme, të kapitalit themelues, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.
- (2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorit parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) i Ligjit.



- (3) Shoqëria do tē drejtohet nga Administratori i zgjedhur nga mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme, i cili emërohet në këtë detyrë pér një periudhë kohore 5(pesë)vjeçare, me tē drejtë niemerimi.
- (4) Administrator i shoqerise emërohet Znj. 1.Engjellushe Veisllari, per një periudhe prej 5 vjetesh, nga data e depozitimit te statutit ne QKB.

#### Neni 18: Kompetencat e Administratorit

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë tē gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6).

Administratori ka këto tē drejta dhe detyrime:

- tē kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë;
- tē përfaqësojë shoqërinë, nē mënyrë aktive ose pasive, përpala çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, nē çdo procedurë, nē çdo shkallë tē gjykimit, si nē Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me tē drejtën pér tē nënshkruar çdo akt ose dokument tē nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me lëshimin e prokurave, mandateve tē veçanta pér avokatë, mbrojtës, tē përgjithshme dhe pér mosmarrëveshje; tē lëshojnë ose tē revokojnë mandate *ad lîtes* avokatëve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjësve tē shoqërisë ose tē tretëve pér një ose më shumë veprime, nē kuadër tē kompetencave përkatëse;
- tē kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*; operacione cedimi kredite) aktive dhe pasive, që ka lidhje me operacione që hyjnë nē objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përbushje tē formalitetave tē nevojshme, duke përfshirë dorëzaninë,
- tē çelin llogari rrjedhëse bankare, tē kryejë tērheqje parash, tē japë dispozita tē pagesës, tē firmosë çeqë që tē kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe tē zbuluar, nē kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (*overcover*), tē verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe tē miratojë llogarinë;
- tē punësojë, tē pezullojë, tē pushojë nga puna dhe tē ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;
- tē ndërvaprojë me Entet e Administratës Publike pér çdo negocim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve tē parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- tē lëshojë ekstrakte tē borderove dhe vërtetëme që lidhen me personelin, si pér entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe pér ente tē tjera ose private; tē kujdeset pér respektimin e përbushjeve, ndaj tē cilave shoqëria është e detyruar, me tē drejtën pér tē nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga tē ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- tē nënshkruajë deklarata fiskale nē lidhje me taksat dhe tatimet nē përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë tē parashikuar nga legjislacioni fiskal nē fuqi, tē kërkojë rimbursime dhe lehtësimë nga taksat dhe tatimet, tē përfaqësojë shoqërinë përpala organeve tē administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore tē çdo shkalle, me tē drejtën pér tē emëruar mbrojtës tē posaçëm;
- tē përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës tē posaçëm;
- tē nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit nē llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike tē llogarive rrjedhëse pér vartësit e shoqërisë pér shumat e depozituara pranë saj;
- tē nënshkruajë kontrata shitblerje tē mallrave dhe shërbimeve, nē kufijtë e objektit tē shoqërisë;
- tē ndërtojë, tē perfundojë dhe tē administrojë marrëdhëniet bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;



- tē kryejë çdo formalitet pér firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumentave të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- tē përfaqësojë shoqërinë në asambletë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëni me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe tē emërojë përfaqësues, tē delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.

(2) Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij komiteteve që përbëhen nga një ose më shumë anëtarë. Një delegim i tillë mund tē bëhet në varësi të kushteve që mund tē vendosë Administratori dhe mund tē revokohet ose tē ndryshohet.

(3) Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë tē pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, tē cilat do tē kishin qenë tē vlefshme, nëse nuk do tē ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do tē ishin dhënë direktiva.

(4) Administratori nuk mund tē delegojë asnjérën prej detyrimeve, tē cilat ia ngarkon ligji.

#### **Neni 19: Skualifikimi dhe largimi i administratorit**

(1) Posti i Administratorit lirohet nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).
2. hyn në procedurën e paftësisë paguese;
3. vuajë ose mund tē vuajë nga çregullime mendore;
4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën Shoqërisë; ose
5. ka munguar pér më shumë se tre muaj radhazi pa lejen në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë ose Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Ortakëve të tjerë vendos ta lirojë nga detyra.

#### **Neni 20: Shpërbëimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit**

- (1) Administratori ka tē drejtë tē marrë shpërbëim pér punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme tē marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund tē japë përfitime, në tē holla, pensione, sigurime ose forma tē tjera, pér ata persona tē cilët kanë punuar më parë pér shoqërinë, ose pér familjarë tē tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose pér persona tē cilët janë në varësi tē tyre, dhe mund tē japë kontribute në fonde tē caktuara pér dhënien e përfitimeve tē tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhëni en punës).

#### **Neni 21: Vendimet e Mbledhjeve të Administratorit**

- (1) Mbledhjet e Administratorit mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.
- (2) Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta pér tē mbajtur detyrën ose nuk ka pasur tē drejtë vote, janë tē vlefshëm njësoj sikur tē gjithë këta persona tē ishin emëruar rregullisht, tē plotësonin kushtet, tē vazhdonin tē ishin Administratorë.

#### **Neni 22: Kufizimet pér votimin**

- (1) Një Administrator nuk lëdh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime pér asnjë çështje në tē cilën ka, drejtëpërdrejtë



ose tērthorazi, një interes ose detyrë me rēndësi materiale dhe që bie ose mund tē bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 tē Ligjit, nëse me vendim tē Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. tē autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
2. ta autorizojnë tē vendosë pér çështjen nē fjalë.

Autorizimi mund tē jetë i përgjithshëm ose i posaçëm pér një çështje tē veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet tē regjistrohet nē Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit.

- (2) Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit tē pranishëm nē një mbledhje nē lidhje me një vendim pér tē cilin nuk ka tē drejtë vote. Pér përashtimin e Administratorit nga marja e vendimit nē një mbledhje tē tillë zakonisht zbatohet përkatësisht Neni 89 i Ligjit.

#### Neni 23: Procesverbalet e mbledhjeve tē Administratorit

1. Administratori kujdeset që nē libra tē posaçëm tē mbajë procesverbalet e tē gjitha takimeve tē bëra nga Administratori.
2. Të tē gjitha punimeve tē mbledhjeve tē Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve tē Administratorit dhe tē komiteteve tē krijuara nga Administratori, përfshirë edhe emrat e personave tē ftuar tē pranishëm nē këto mbledhje.

### TITULLI V Dividentët dhe kapitalizimi i fitimeve

#### Neni 24: Dividentët

- (1) Pas përbushjes së kërkesave tē Nenit 77 tē Ligjit, shoqëria, me anë tē një vendimi tē kualifikuar, mund tē shpallë dividentë nē përputhje me tē drejtat përkatëse tē ortakëve.
- (2) Me përashtim tē rasteve kur parashikohet ndryshe nga tē drejtat që u lidhen kuotave, tē gjithë dividentët deklarohen dhe paguhën nē përputhje me shumat e paguara pér kuotat nē lidhje me tē cilat paguhet dividenti. Të gjithë dividentët përpjesëtohen dhe paguhën nē përpjesëtim me shumat e paguara pér kuotat gjatë pjesës ose pjesëve tē periudhës nē lidhje me tē cilat paguhet dividenti. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr divident, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota nē fjalë e merr dividentin sipas këtij kushti.
- (3) Asnjë divident dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm nē lidhje me një kuotë nuk mund tē fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet nē tē drejtat që i lidhen kuotës.
- (4) Nëse një divident nuk është tērhequr pas dyshëdhjetë vjetëve nga data kur mund tē tērhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim tē kualifikuar, ky divident mund tē anullohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

#### Neni 25: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur nē konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratorët mund tē vendosin tē kapitalizojnë fitimet e pashpëmdara tē shoqërisë që nuk kërkohen pér tē paguar dividente preferenciale ose borxhe tē tjera tē pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

### TITULLI VI Prishja dhe Njoftimet

#### Neni 26: Prishja dhe Likuidimi



Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

#### Nenl 27: Njoftimet

- (1) Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të janë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4, paragrafi (8) të këtij statuti që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.
- (2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me poste në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruveve në përputhje me Nenin 7, paragrin (2) të Ligjit.
- (3) Në këtë statut, përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë, vendosen nga Administratori në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4, paragrafi (2) i këtij Statuti.

#### Nenl 28: Dispozita të përgjithshme

Përsa i përket çëshjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008.

Selia e shoqërisë duhet të ketë të mbishkruar pas kësaj të paktën emrin e shoqërisë, numrin e vendimit dhe vitin e inkorporimit dhe fjalët "Vula e shoqërisë".

Çdo mosmarrëveshje që del nga kjo marrëveshje do të caktohet para gjykatës së vendit, ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqërisë.

#### Nenl 29: Dispozita përfundimtare

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbylljet me 29 (Njëzet e nëntë) nene. Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKR.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

Emri dhe Nënshkrimi i Ortakut Themelues të:

Shoqërisë Tregtare "Jes Finance&Accounting" SH.P.K.

(1.Engjellushe Veisllari)

*Engjellushe Veisllari* 

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Jes Finance&Accounting" SH.P.K  
Faqe 9 deri 9